

GJYKATA SUPREME

Çështja numër:

Pml.Kzz 145/2014

(PP Nr. 16/2013 Gjykata Themelore e Prishtinës)

Data:

8 tetor 2014

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Timo Vuojolahti (kryesues dhe raportues), gjyqtarja e Gjykatës Supreme, Marie Ademi dhe gjyqtarja e Gjykatës Supreme Emine Mustafa si anëtare të kolegjit, si dhe zyrtari ligjor i EULEX-it Kerry Kirsten Moyes si procesmbajtës, në çështjen penale 16/2013 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, në çështjen penale kundër;

MS, i arrestuar më 18 mars 2014, në paraburgim që nga 19 marsi 2014

dhe të tjerët

i dyshuar për këto vepra penale:

Krimi i organizuar, në kundërshtim me nenin 283 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK), në lidhje me veprën penale të **Kontrabandimit me migrantë**, në kundërshtim me nenin 170 paragrafi 2 të Kodit Penal i Kosovës (KPK);

Krimi i organizuar, në kundërshtim me nenin 283 paragrafi 2 të KPK-së, në lidhje me veprën penale të **Kontrabandimit me migrantë**, në kundërshtim me nenin 170 paragrafi 1 të KPK-së;

duke vepruar sipas Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga Kryeprokurori i Shtetit më 4 korrik 2014 kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN.1.1215/2014 në këtë çështje të datës 27 qershor 2014, që e pranonte si të afatshme ankesën e të pandehurit dhe e refuzonte atë si të pabazuar.

pas shqyrtimit të Përgjigjes ndaj Kërkesës së avokatit mbrojtës Osman Mehmeti në emër të të pandehurit të paraqitur më 30 korrik 2014;

pasi u këshillua dhe votoi më 8 tetor 2014;

bazuar në nenet 418 dhe nenet 432-441 të Kodit të Procedurës Penale (KPP)

nxori këtë

AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Kryeprokurori i Shtetit më 4 korrik 2014 kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN.1. 1215/2014, të datës 27 qershor 2014, është e bazuar mirë. Me atë Aktvendim, Gjykata e Apelit e ka shkelur ligjin penal, nenet 189 paragrafi 3 dhe 478 paragrafi 4 të KPP-së, kur e kishte pranuar si të afatshme ankesën e paraqitur nga avokati mbrojtës i të pandehurit kundër urdhrit për vazhdim të masës së paraburgimit.

ARSYETIMI

1. Historiku procedural

1.1. Hetimi ndaj të pandehurit kishte filluar më 30 prill 2013. Ai ishte arrestuar më 18 mars 2014 dhe masa e paraburgimit ishte urdhëruar kundër tij (dhe kundër të bashkë-akuzuarit) më 19 mars 2014 për një (1) muaj. Më pastaj u vazhdua për dy (2) muaj e që skadonte më 18 qershor 2014.

1.2. Më 13 qershor 2014 prokurori e paraqiti kërkesën për vazhdim të paraburgimit ndaj të pandehurit edhe për dy (2) muaj. Më 18 qershor 2014, gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore të Prishtinës e miratoi kërkesën e prokurorit dhe e urdhëroi vazhdimin e masës së paraburgimit që skadonte më 18 gusht 2014.

1.3. Ky Aktvendim i ishte dorëzuar të pandehurit më 19 qershor 2014, dhe avokatit të tij mbrojtës më 23 qershor 2014. Ankesa u paraqit nga avokati mbrojtës Osman Mehmeti në emër të të pandehurit më 24 qershor 2014. Prokurori ankues i propozoi Gjykatës së Apelit që ta hedh poshtë ankesë si të paafatshme. Gjykata e Apelit vendosi që ankesa ishte e pranueshme dhe e paraqitur me kohë, por e refuzoi atë si të pabazuar.

1.4. Më 4 korrik 2014 Kryeprokurori i Shtetit paraqiti Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Më 30 korrik 2014 u paraqit një Përgjigje nga avokati mbrojtës Osman Mehmeti në emër të të pandehurit.

2. Dorëzimi nga palët

2.1. Kërkesa e paraqitur nga Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës

Prokurori deklaroi se me Aktvendimin PP nr. 16/2013 të datës 18 qershor 2014 Gjykata Themelore e Prishtinës kishte vazhduar masën e paraburgimit kundër të pandehurit (dhe të bashkë-akuzuarit) deri më 18 gusht 2014. Aktvendimi ishte dorëzuar të pandehurit më 19 qershor 2014, dhe avokatit mbrojtës të të pandehurit më 23 qershor 2014. Gjersa i pandehuri vetë nuk kishte paraqitur ankesë kundër këtij Aktvendimi, avokati mbrojtës e paraqiti këtë

ankesë më 24 qershor 2014. Gjykata e Apelit gjeti se ankesa ishte e afatshme. Prokurori konsideroi se duke vepruar ashtu Gjykata e Apelit e shkeli neni 478 paragrafi 4 të KPP-së.

Prokurori i referohet nenit 478 paragrafit 4 të KPP-së në të cilin thuhet se afati për ushtrimin e mjetit juridik apo të përgjigjes në ankesë rrjedhë nga dita e dorëzimit të shkresës të pandehurit. Por, Gjykata e Apelit, megjithë formulimin e qartë të Kodit, e ka lejuar ankesën si të afatshme. Gjykata e Apelit, me arsyetimin e cekur në Aktvendimin e saj, ka konsideruar se interpretimi i fjalëpërfjalshëm i kësaj dispozite do të rezultonte në kundërthënie me parimet themelore të procedurës penale, dhe si rrjedhojë afati kohor për avokatin mbrojtës që ta paraqesë ankesën fillon në datën kur atij ose asaj i dorëzohet Aktvendimi. Përfundim në këtë mund të bëhet në rastet kur avokati mbrojtës ishte në dijeni në datën kur Aktvendimi i ishte dorëzuar të pandehurit.

Prokurori argumenton se Gjykata e Apelit mori qëndrim të njëjtë në Aktvendimet KP 05/2013 të datës 6 shkurt 2013 dhe PN/KR 23/13 të datës 14 janar 2013. Kjo qasje ishte temë e Aktgjykimit PKL Nr. 22/2013, të datës 4 mars 2013 të Gjykatës Supreme, që përcaktoi se Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë ishte e bazuar mirë dhe deklaroi se kishte shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit. Në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme thuhej se as Gjykata e as palët nuk mund ta ndërrojnë në afat kohor të parashikuar ligjërisht. Dispozita është e qartë dhe vendimtare, dhe Gjykata nuk është dashur të vendos në kundërshtim me të ose ta interpretojë atë sikurse ka bërë në vendimin e saj. Prokurori konsideron se Gjykata e Apelit jo vetëm që e kishte shpërfillur një dispozitë të qartë dhe të sqaruar të KPP-së mbi bazën se ajo thjeshtë nuk pajtohej me të, por duke e shpërfillur një vendim të Gjykatës Supreme, Gjykata po ashtu kishte shkelur autoritetin e Gjykatës Supreme duke shkaktuar pasiguri ligjore.

Prokurori deklaroi se Gjykata e Apelit ka krijuar një dispozitë të re ligjore sa u përket afateve kohore për paraqitje të ankesës. Megjithatë, sa i përket kësaj çështje, në ligjin procedural nuk ka ndonjë zbrazëti normative që duhet të plotësohet, e as ndonjë dispozitë të paqartë që duhet të sqarohet. Gjykata nuk do të duhej të përshtaste një interpretim *contra legem* të një rregulle të legjislacionit vendor, siç kishte bërë ajo tani, pasi që kjo është në kundërshtim me parimin e sigurisë ligjore dhe është jashtë autoritetit të Gjykatës. Çdo konflikt i perceptuar ndërmjet të vlerave kushtetuese dhe dispozitës legislative do të duhej të zgjidhej me procedurën në nenin 113 të Kushtetutës për shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese.

Gjersa prokurori pajtohet se kjo është vërtetuar mirë në ligjin për të drejtat e njeriut se një mjet juridik duhet të jetë në dispozicion në teori dhe në praktikë, ai deklaroi se në rastin e pikërishtëm ka pasur kohë të mjaftueshme që avokati mbrojtës t'i mbrojë si duhet interesat e të pandehurit, dhe se nuk ka pasur asnjë veprim ose lëshim nga autoritetet shtetërore të cilat e kanë penguar ushtrimin e mjetit juridik. KPP po ashtu i siguron të pandehurit edhe një mjet juridik shtesë, e ai është, mbikëqyrja e masës së paraburgimit nga Gjykata. Në këtë rast, i pandehuri ishte ndihmuar nga avokati mbrojtës, nuk ishte ofruar asnjë shpjegim qoftë nga i pandehuri ose nga avokati mbrojtës në lidhje me mosparaqitjen e ankesës brenda afatit të përcaktuar kohor, dhe Gjykata e Apelit ka elaboruar mbi pengesat hipotetike sa i përket

paraqitjes me afat të ankesës. Sjellja e mbrojtjes është një çështje në mes të pandehurit dhe avokatit të tij, dhe ky i fundit pritet të luajë një rol aktiv në procedurën penale, dhe në këtë rast duket se avokati mbrojtës në mënyrë të pakujdesshme ka pritur që t'i dorëzohet Aktvendimi.

Prokurori i propozon Gjykatës Supreme që ta ripohojë parimin e shprehur në vendimin e Gjykatës Supreme PKL nr. 22/2013 të datës 4 mars 2013 dhe të deklarojë se Aktvendimi i ankimuar e kishte shkelur nenin 478 paragrafi 4 i KPP-së bazuar në nenin 384 paragrafi 2.1 të KPP-së.

2.2. Përgjigja e avokatit mbrojtës

Avokati mbrojtës propozon se nuk ka pasur shkelje të ligjit siç pretendohet nga prokurori. Ai ishte pyetur nga zyrtari ligjor i EULEX-it, rreth gjysmës së muajit qershor, nëse ai do të mund ta merrte rastin e të pandehurit *sipas detyrës zyrtare*, dhe pastaj e mori kërkesën e prokurorit për vazhdim të masës së paraburgimit qoftë nga zyra e Gjyqtarëve të EULEX-it ose të Gjykatës Themelore të Prishtinës. Ai e kishte marrë Aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake PP. Nr. 16/2013 në Gjykatën Themelore. Ai nuk ishte në gjendje të kontaktonte me të pandehurin pasi që nuk e dinte se në cilën qendër të paraburgimit po mbahej ai. Kjo ishte për shkak se i pandehuri kishte një avokat tjetër mbrojtës *sipas detyrës zyrtare* kur i ishte caktuar masa e paraburgimit. Ai kishte kërkuar që në të ardhmen i pandehuri ta informonte menjëherë atë për çdo vendim të Gjykatës që ai do të merrte.

3. Gjetjet e kolegjit

3.1. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nga prokurori dhe Përgjigja e paraqitur nga avokati mbrojtës janë të pranueshme dhe të afatshme.

Faktet dhe pyetja e rastit

3.2. Kolegji vëren se Aktvendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake PP nr. 16/2013 i datës 18 qershor 2014, që e miratoi kërkesën e prokurorit dhe urdhëroi vazhdimin e masës së paraburgimit, i ishte dorëzuar të pandehurit më 19 qershor 2014 dhe avokatit mbrojtës më 23 qershor 2014. Avokati mbrojtës Osman Mehmeti kishte paraqitur ankesë më 24 qershor 2014 në emër të të pandehurit **MS**. I pandehuri nuk e kishte paraqitur vetë ankesën.

3.3. Gjykata e Apelit konsideroi se ankesa ishte e afatshme, por e refuzoi atë si të pabazuar.

3.4. Andaj, pyetja në këtë rast është: a ishte paraqitur ankesa në emër të të pandehurit Sejdiu nga avokati i tij mbrojtës brenda afatit duke marrë parasysh faktet më lart.

Ligji

3.5. Neni 189 paragrafi 3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) parasheh që:

‘...Secila palë mund të paraqesë ankesë brenda njëzet e katër (24) orëve nga koha e dorëzimit të aktvendimit.’

3.6. Neni 478 paragrafi 4 i KPP-së parasheh që:

(4) Në qoftë se i pandehuri ka mbrojtës, shkresa nga paragrafi 2. i këtij neni i dërgohet mbrojtësit dhe të pandehurit në pajtim me dispozitat e nenit 477 të këtij Kodi. Në rastin e tillë, afati për ushtrimin e mjetit juridik apo të përgjigjes në ankesë rrjedhë nga dita e dorëzimit të shkresës të pandehurit...

3.7. Neni 445 paragrafi 1 i KPP-së parasheh që:

(1) Afatet e parapara me këtë Kod nuk mund të vazhdojnë, përveç kur këtë shprehimisht e lejon ligji. Në qoftë se afati për realizimin e të drejtës së mbrojtjes dhe të drejtave të tjera procedurale të të pandehurit është paraparë me ligj, me kërkesën e tij me shkrim ose gojarisht në procesverbalin e gjykatës ky afat mund të shkurtohet.

3.8. Ekzistojnë edhe dispozita të tjera relevante në KPP që e rregullojnë të drejtën e avokatit mbrojtës dhe pozitën kur aty ka disa avokatë mbrojtës.

Së pari, në nenin 53 paragrafi 1 i KPP-së thuhet:

dyshuari dhe i pandehuri kanë të drejtë të kenë mbrojtës gjatë gjithë fazave të procedurës penale.

Së dyti, në nenin 55 paragrafët 2 dhe 3 të KPP-së thuhet:

(2) I pandehuri mund të ketë deri në tre (3) mbrojtës dhe e drejta për mbrojtje konsiderohet se është e mjaftueshme kur në procedurë merr pjesë njëri nga mbrojtësit.

(3) Nëse i pandehuri ka më shumë se një mbrojtës, njëri nga ta caktohet si mbrojtës kryesor nga i pandehuri, e në rast se i pandehuri nuk bën një gjë të tillë, gjyqtari kompetent cakton mbrojtësin kryesor.

Së treti, në nenin 478 paragrafi 5 i KPP-së parasheh që:

(5) Kur shkresa duhet dorëzuar mbrojtësit të të pandehurit dhe i pandehuri ka më shumë se një mbrojtës, mjafton t'i dorëzohet njërit prej tyre.

Së katërti, në nenin 19 paragrafi 1.28 i KPP-së thuhet:

(1) Shprehjet e përdorura në këtë Kod të Procedurës Penale kanë këto kuptime:

1.28. Mbrojtësi kryesor - kur një palë përfaqësohet nga më shumë se një mbrojtës, një dhe vetëm një mbrojtës përfaqëson palën para gjykatës ose gjatë procedurave penale. Kur mbrojtësit kryesor i dorëzohen dokumentet, përfshirë aktakuzat, kërkesat, përgjigjet, ankesat dhe dokumentet tjera të cilat duhet t'i zbulohen të pandehurit, konsiderohet se dorëzimi u është bërë të gjithë mbrojtësve që përfaqësojnë palën.

Vlerësimi

3.9. Së pari, kolegji i Gjykatës Supreme vë në dukje se rregullat e përcaktuara në nenet 189 paragrafi 3 dhe 478 paragrafi 4 i KPP-së janë të qarta: afati kohor për paraqitje të ankesës kundër një Aktvendimi me të cilin urdhërohet masa e paraburgimit është 24 orë, dhe ajo fillon në datën kur Aktvendimi i dorëzohet të pandehurit. Për më tepër, neni 445 paragrafi 1 i KPP-së e fuqizon natyrën absolute të këtij kufizimi kohor.

3.10. Megjithatë në Aktvendimin e kundërshtuar, Gjykata e Apelit i ka paraqitur argumentet të cilat ajo konsideron se ofrojnë arsye dhe arsyetim të mjaftueshëm për të devijuar nga rregulla se afati kohor për paraqitje të ankesës fillon në datën kur dokumenti i dorëzohet të pandehurit. Ndonëse argumentet e prezantuara janë të arsyetuara, kolegji i Gjykatës Supreme konsideron se ato nuk mund ta justifikojnë përjashtimin ndaj dispozitave të qarta në KPP.

3.11. Fillimisht, sa i përket afatit kohor prej 24 orësh për paraqitje të ankesës, kolegji i Gjykatës Supreme thekson si më poshtë:

Në njërin anë mund të argumentohet se e drejta e ankesës (neni 189 paragrafi 3) dhe e drejta për t'u ndihmuar nga një avokat mbrojtës (neni 53 paragrafi 1) janë joefektive pasi që afati kohor është aq i shkurtër. Gjykata e Apelit spekulon se avokatit mbrojtës mund të mos i jetë dorëzuar Aktvendimi në të njëjtën ditë sikurse të pandehurit, ose se i pandehuri nuk ka mundur ta kontaktojë avokatin mbrojtës me kohë. Ndonëse i pandehuri mund të paraqesë ankesë vetë, kjo do t'ia mohonte atij të drejtën për ndihmë juridike, që është mishëruar në kuadër të parimit për një gjykim të drejtë dhe po ashtu është e detyrueshme në rrethana të caktuara.

Megjithatë, kolegji i Gjykatës Supreme i refuzon këto argumente. Ndonëse qëllimi kryesor sa i përket afatit të shkurtër kohor mund të konsiderohet si diçka që të mbrojtë të drejtat e mbrojtjes, qëllimi tjetër sigurisht është në mbështetjen e synimit të përgjithshëm për të kryer procedura në mënyrë të shpejtë dhe efektive. Domethënë, është relevante të vihet në pah se i pandehuri gjithmonë, pas asnjë kufizim kohor, e ka mundësinë që të parashtrojë kërkesë për mbikëqyrje të paraburgimit nga gjykata siç parashihet nga neni 192 i KPP-së.

I pandehuri gjithmonë e ka të drejtën që të kontaktojë me avokatin e vet mbrojtës, qoftë kur është në paraburgim ose në liri. Që të dy, si i pandehuri ashtu edhe avokati i tij mbrojtës janë në dijeni të periudhës së shkurtër për paraqitje të ankesës, dhe ata duhet të përgatiten që të veprojnë menjëherë. Avokati mbrojtës që e përfaqëson të pandehurin i cili i është nënshtruar masës së paraburgimit do të jetë i vetëdijshëm se kur është urdhëruar ose është vazhduar

masa, dhe duhet ta dijë se Aktvendimi do të dorëzohet pa asnjë vonesë. Avokati mbrojtës po ashtu duhet ta dijë se ai/ajo e merr Aktvendimin në të njëjtën ditë sikur i pandehuri, dhe mund ta marrë atë më vonë. Andaj, avokati mbrojtës ka përgjegjësi të qartë që të jetë proaktiv dhe i përgatitur për të vepruar pa vonesa, se sa të presë në mënyrë pasive për që Aktvendimet t'i dorëzohen atij/asaj. Kolegji po ashtu vëren se zakonisht avokati mbrojtës ia del të paraqesë ankesë me afat.

3.12. Së dyti, sa i përket argumentit se kur i pandehuri dhe avokati mbrojtës kanë të drejta të ndara për të ushtruar ankesë, kjo do të thotë se duhet që po ashtu të ketë afate të ndara për ta, Kolegji i Gjykatës Supreme thekson si më poshtë:

Gjykata e Apelit ishte e mendimit se meqë i pandehuri dhe avokati mbrojtës kanë të drejta të ndara sa i përket paraqitjes së ankesës, kështu që pason që afate kohore të ndara caktohen për këtë, në rast të kundërt si rrjedhojë vjen një situatë e padrejtë që nuk ka mundur të ketë qenë qëllimi i ligjvënësit.

Siç e parasheh neni 55 paragrafët 2 dhe 3 të KPP-së një pandehuri mund të ketë deri në tre mbrojtës, dhe kur i pandehuri ka më shumë se një mbrojtës, njëri nga ta caktohet si mbrojtës kryesor nga i pandehuri. Argumenti se i pandehuri dhe avokati mbrojtës do të duhej të kishin afate të ndara do ta shtronte pyetjen nëse të gjithë avokatët mbrojtës do të duhej të kishin afate të veçanta për ushtrim të ankesës, ose a do të duhej që afati kohor të fillojë për të gjithë ata kur aktvendimi i dorëzohet njërit prej tyre, mbase vetëm mbrojtësit kryesor siç do të sugjeronte neni 19 paragrafi 1.28 i KPP-së.

Në njërin anë mund të argumentohet se vetëm një ankesë mund të paraqitet nga disa avokatë mbrojtës (fjalja e parë e nenit 19 paragrafi 1.28 të KPP-së), por praktika në Kosovë ka qenë që të pranohen ankesat e ushtruara nga secili prej avokatëve mbrojtës të të njëjtit të pandehurit. Kështu që, në anën tjetër, nëse kjo pranohet, do të ishte e pamundshme që të përcaktohet se cili ishte momenti i saktë se kur fillon afati kohor për secilin avokat mbrojtës. Ndërsa në fjalinë e dytë e nenit 19 paragrafi 1.28 i KPP-së thuhet se kur dokumentet i dorëzohen mbrojtësit kryesor, atëherë konsiderohet se dorëzimi u është bërë të gjithë mbrojtësve, është fakt se mbrojtësit e tjerë domosdoshmërisht nuk do të kenë ndonjë njohuri për momentin se kur i është dorëzuar Aktvendimi mbrojtësit kryesor, dhe si rrjedhojë edhe e momentit se kur fillon të rrjedhë koha edhe për ta. I njëjti lloj i situatës do të paraqitej kurdo që Aktvendimi i dorëzohet vetëm njërit prej avokatëve mbrojtës, bazuar në nenin 478 paragrafi 5 të KPP-së. Është e qartë se ligjvënësi nuk ka pasur për qëllim që të krijojë një situatë të tillë të mjegullt. Dhe sigurisht, duke i marrë parasysh afatet e shkurtra kohore që Gjykata e Apelit të vendos lidhur me ankesën, ligjvënësi nuk e ka krijuar një sistem kur një numër ankesash të paraqitura në emër të të pandehurit të njëjtë do të mund të paraqiteshin gjatë një periudhe kohore prej disa ditësh, dhe kështu ka vendosur ndarazi.

Duhet të ketë një supozim që ligjvënësi ka qenë racional në qasjen e vet, për të siguruar që dispozitat e ndryshme në ligj që e rregullojnë një çështje të caktuar të jenë koherente dhe konsistente me njëra tjetrën. Kur ligjvënësi i cakton rregullat për të lejuar që disa avokatë

mbrojtës të një të pandehuri, nuk i caktoi rregullat që do të shfaqnin që të drejtat e tyre për ta përfaqësuar të pandehurin janë të ndara nga të drejtat e të pandehurit në lidhje me këtë çështje. Ligjvënësi ka pasur një numër mundësish që t'i lejonte afate të ndara kohore për paraqitje të ankesave, të pandehurit dhe avokatit të tij/saj mbrojtës, dhe nuk e ka bërë këtë gjë. Kolegji i Gjykatës Supreme konstaton se qëllimi i veçantë i ligjvënësit ishte që afati kohor të jetë nga koha kur të pandehurit i dorëzohet shkresa, dhe duke e bërë këtë gjë ka vlerësuar plotësisht se ky është një afat i shkurtër kohor.

3.13. Kolegji i Gjykatës Supreme nuk pajtohet që interpretim i fjalëpërfjalshëm i ligjit në këtë çështje prodhon një rezultat që është i kundërt me dispozitat dhe parimet themelore të procedurës penale. Kolegji konsideron rezultatin më shumë si pritje që mbrojtësit mbesin të informuar për datat e skadimit të afateve të masës së paraburgimit për klientët e tyre, dhe se ata veprojnë në përputhje me këtë. Kjo pritje është e arsyeshme, dhe se është plotësisht në përputhje me detyrën profesionale të avokatëve mbrojtës ndaj klientëve të tyre. Kështu që, për shkak të afateve të shkurtra kohore për paraqitje të ankesës, të dy, si mbrojtësi ashtu edhe i pandehuri duhet të jenë proaktiv dhe të angazhuar plotësisht me njëri tjetrin e edhe sa i përket procedurës siç është formuluar në KPP, kushtet e të cilit është krejtësisht e mundshme të plotësohen me kusht që të mos merret një qasje pasive dhe e shkujdesur. Andaj, garancitë nga konventat ndërkombëtare përkitazi me të drejtat e të pandehurit lidhur me disponibilitetin e ankesave kundër vendimeve me të cilat urdhërohet ose vazhdohet masa e paraburgimit, si dhe sigurimi i ndihmës juridike për të njëjtën, si të tilla nuk mohohen nga dispozitat e KPP-së.

Në anën tjetër, kolegji i Gjykatës Supreme vë në dukje se është obligim i të gjitha autoriteteve gjyqësore që në kryerjen e detyrave të tyre t'u kushtojnë vëmendje të veçantë të drejtave të të pandehurit, me qëllim që t'i garantojnë ato siç parashihen me ligj dhe konventat ndërkombëtare në fuqi. Kjo do të thotë, për shembull, që edhe policia dhe autoritetet e shërbimit korrektues të përkujdesen që i pandehuri, në praktikë, të ketë mundësi ta përdorë në mënyrë efektive të drejtën e tij/saj për ankesë si dhe të drejtën për ndihmë juridike.

Kolegji i Gjykatës Supreme konstaton se në këtë rast avokati mbrojtës ka paraqitur një ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 18 qershor 2014 pas skadimit të afatit të paraparë kohor për paraqitje të ankesës. Nuk ka asnjë indikacion se i pandehuri ose avokati i tij mbrojtës në ndonjë mënyrë janë penguar nga mundësia për ta shfrytëzuar në mënyrë efektive të drejtën për të ushtruar ankesë brenda afateve kohore. Përkundrazi, siç deklarohej nga avokati mbrojtës, ai nuk ka marrë asnjë veprim për t'u përpjekur që ta kontaktojë klientin e tij, e as që është përpjekur ta gjeje se ku ishte paraburgosur klienti i tij. Kështu që kjo më shumë i referohet mosveprimit ose vonesës së vet avokatit mbrojtës.

3.14. Në përmbledhje, prokurori prezanton një argument të tërësishëm dhe obligativ në Kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë dhe kolegji i Gjykatës Supreme është në pajtim të plotë. Kolegji i Gjykatës Supreme konstaton se nuk është e hapur që Gjykata e Apelit ta zëvendësojë dispozitën legislative të saktësuar dhe të formuluar në mënyrë të qartë me një të

sajuar nga vetë ajo. Nëse Gjykata e Apelit është e pikëpamjes se neni 478 i KPP-së është në kundërshtim me parimet kushtetuese, çështja duhet të ngritet në mënyrën që e parasheh Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

3.15. Kështu që, kolegji i Gjykatës Supreme gjen se Kërkesa e paraqitur nga prokurori është e bazuar mirë. Bazuar në nenin 438 paragrafi 2 të KPP-së, Gjykata Supreme vetëm konstaton se ligji është shkelur kur Gjykata e Apelit e gjeti ankesën e ushtruar nga avokati mbrojtës Osman Mehmeti në emër të të pandehurit **MS** si të afatshme.

I përgatitur në anglisht, gjuhë e autorizuar.

Gjyqtari Kryesues

Procesmbajtësi

Timo Vuojolahti
Gjyqtar i EULEX-it

Kerry Kirsten Moyes
Zyrtar ligjor i EULEX-it

Anëtare të kolegjit

Marie Ademi
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Emine Mustafa
Gjyqtare e Gjykatës Supreme